

## Marrës AV shumëkanalësh

Udhëzuesi i referencës

## PARALAJMËRIM

**Për të reduktuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, kjo aparaturë nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështirës.**

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj. Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të pambrojtura (për shembull qirinjtë ndezur).

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve dhe mbi pajisje nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo.

Mos e instaloni pajisjen në hapësira të kufizuara si p.sh. në raftë librash apo në mobilie inkaso.

Duke qenë se spina kryesore përdoret për të shkëputur njësinë nga rrjeti elektrik, futeni njësinë në priza elektrike që mund të arrihen lehtë. Nëse vini re një anomali në njësi, shkëputni menjëherë prizën kryesore nga priza e rrymës së drejtpërdrejtë.

Mos e ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

Njësia nuk shkëputet nga rrjeti elektrik për sa kohë që është futur në prizë, edhe nëse vetë njësia është e fikor.

Presioni i tepruar i zërit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.



Ky simbol njofton përdoruesin për sipërfaqe të nxehta, e cila mund të jetë e tillë nëse preket gjatë punës normale.

## Për klientët në Evropë



**Hedhja e baterive të përdorura dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sistem grumbullimi të diferencuar)**

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketim tregon se produkti dhe bateria nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0,0005% zhivë ose 0,004% plumb. Duke u siguruar që këto produkte dhe bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkomporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë dhe pajisjes elektrike dhe elektronike, dorëzoni këto produkte në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzoni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin ose baterinë.

## **Njoftim për klientët: Informacioni i mëposhtëm aplikohet vetëm për pajisjet e shitura në vendet ku aplikohen Direktivat e BE-së.**

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjisllacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtoju adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.

### **Rreth të drejtave të autorit**

Ky marrës përmban Dolby\* Digital dhe Pro Logic Surround dhe DTS\*\* Digital Surround System.

- \* Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Pro Logic dhe simboli me dy "D" janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- \*\* Për patentat DTS shihni <http://patents.dts.com>. Prodhuar me licencë nga DTS Licensing Limited. DTS, DTS-HD, simboli i saj dhe DTS dhe simboli i saj së bashku janë marka tregtare të regjistruara të DTS, Inc. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky marrës përmban teknologji High-Definition Multimedia Interface (HDMI™) (Ndërfaqe multimediale me definicion të lartë).

Termat HDMI dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, si dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

iPhone, iPod, iPod classic, iPod nano dhe iPod touch janë marka të Apple Inc., të regjistruara në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.

Të gjitha markat e tjera tregtare dhe të regjistruara tregtare janë të pronarëve përkatës. Në manual nuk përcaktohen markat ™ dhe ®.

"Made for iPod" dhe "Made for iPhone" nënkuptojnë se një aksesor elektronik është projektuar për t'u lidhur në mënyrë specifike përkatësisht me një iPod ose iPhone dhe është certifikuar nga zhvilluesi i tij se përputhet me standardet e performancës së Apple. Apple nuk është përgjegjëse për funksionimin e kësaj pajisjeje ose pajtueshmërinë e saj me standardet rregullatore dhe të sigurisë. Ju lutemi vini re se përdorimi i këtij aksesori me iPod ose iPhone mund të ndikojë në performancën e lidhjes me valë.

Windows Media është marka tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.

Ky produkt mbrohet nga teknologji të caktuara që janë subjekti i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft Corporation. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencë nga Microsoft apo një filial i autorizuar i Microsoft.

Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.

"x.v.Color (x.v.Colour)" dhe logoja "x.v.Color (x.v.Colour)" janë marka tregtare të Sony Corporation.

"BRAVIA" është markë tregtare e Sony Corporation.

"PlayStation" është markë e regjistruar tregtare e Sony Computer Entertainment Inc.

"WALKMAN" dhe simboli "WALKMAN" janë marka të regjistruara tregtare të Sony Corporation.

MICROVAULT është markë tregtare e Sony Corporation.

MHL, Mobile High-Definition Link dhe simboli MHL janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të MHL Licensing, LLC.

## Masat paraprake

### Mbi sigurinë

Nëse brenda në mobilie bie diçka e fortë ose lëng, marrësi duhet të hiqet nga prizat dhe duhet të kontrollohet nga një personel i kualifikuar përpara se të vihet sërish në punë.

### Mbi burimet e rrymës

- Përpara se të përdorni marrësin, kontrolloni që tensioni i përdorimit të jetë identik me furnizimin vendas me energji. Tensioni i përdorimit tregohet në pllakëzën metalike në pjesën e pasme të marrësit.
- Njësia nuk shkëputet nga burimi i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) për sa kohë që është e lidhur me prizën e murit, edhe nëse njësia vetë është e fikur.
- Nëse nuk do ta përdorni marrësin për një kohë të gjatë, sigurohuni që ta shkëputni marrësin nga prizat e murit. Për të shkëputur kordonin elektrik (nga rrjeti elektrik) kapeni te spina; mos tërhiqni asnjëherë kordonin.
- Kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) duhet të zëvendësohet vetëm nga një dyqan servisi i kualifikuar.

### Mbi akumulimin e nxehtësisë

Megjithëse marrësi nxehet gjatë punës, ky nuk është keqfunksionim. Nëse e përdorni këtë marrës vazhdimisht me volum të lartë, temperatura e kabinetit të pjesës së sipërme, anësore dhe të poshtme, rritet në mënyrë të konsiderueshme. Për të shmangur djegien, mos e prekni kabinetin.

### Mbi vendosjen

- Vendoseni marrësin në një vend me ajrosje të mjaftueshme për të parandaluar akumulimin e nxehtësisë dhe për të shtuar jetëgjatësinë e marrësit.
- Mos e vendosni marrësin pranë burimeve të nxehtësisë siç janë radiatorët, tubacionet e ajrit, ose në një vend ku bie drita e drejtpërdrejtë e diellit, ku ka pluhur të tepërt, ose tronditje mekanike.
- Mos vendosni asgjë mbi pjesën e sipërme të kabinetit që mund të bllokojë vrimat e ajrimit dhe të shkaktojë keqfunksionime.
- Mos e vendosni marrësin pranë pajisjeve të tilla si televizorë, VCR ose magnetofona. (Nëse marrësi përdoret në kombinim me një televizor, VCR, ose magnetofon, dhe vendoset shumë pranë asaj pajisjeje, mund të krijohet zhurma dhe mund të prishet cilësia e figurës. Kjo mund të ndodhë sidomos kur përdorni një antenë të brendshme (ajrore). Për këtë arsye, rekomandojmë që të përdorni një antenë të jashtme (ajrore).)
- Kini kujdes kur vendosni marrësin mbi dysheme me trajtim të veçantë (të trajtuara me dyllë, vaj, me lustër, etj.), duke qenë se mund të rezultojë në njolla ose çngjyrosje.

### Mbi përdorimin

Përpara se të lidhni pajisje të tjera, sigurohuni që të fikni dhe hiqni nga prizat marrësin.

### Mbi pastrimin

Pastroni mobilien, panelin dhe kontrollet me një pëlhurë të butë të njomur paksa me një solucion larës të butë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si alkooli ose benzina.

Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me marrësin tuaj, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

# Specifikimet

## Seksioni i amplifikatorit

Fuqia minimale e daljes RMS<sup>1)</sup>  
(6 om, 20 Hz – 20 kHz, THD 0,09%)  
90 W + 90 W

Fuqia në dalje në modalitetin stereo<sup>1)</sup>  
(6 om, 1 kHz, THD 1%)  
105 W + 105 W

Fuqia në dalje në modalitetin rrethues<sup>1)2)</sup>  
(6 om, 1 kHz, THD 0,9%)  
145 W për kanal

- <sup>1)</sup> Matur në kushtet e mëposhtme:  
Furnizimi me energji: 230 V AC, 50 Hz
- <sup>2)</sup> Dalja referencë e fuqisë për altoparlatët  
e përparmë, qendrorë dhe rrethues. Në varësi  
të cilësimeve të fushës zanore dhe të burimit,  
mund të mos ketë fare dalje të zërit.

## Reagimi i frekuencës

Analoge  
10 Hz – 100 kHz, +0,5/-2 dB  
(me fushën zanore dhe balancuesin  
e kapërcyer)

## Hyrja

Analoge  
Ndjeshmëria: 500 mV/50 kiloom  
S/N<sup>3)</sup>: 105 dB (A, 500 mV<sup>4)</sup>)  
Dixhital (koaksial)  
Rezistenca: 75 om  
S/N: 100 dB (A, 20 kHz LPF)  
Dixhital (optik)  
S/N: 100 dB (A, 20 kHz LPF)

## Dalja (analoge)

SUBWOOFER  
Tensioni: 2 V/1 kiloom

## Balancuesi

Nivelet e përforcimit  
±10 dB, hapi 1 dB

<sup>3)</sup> INPUT SHORT (me fushën zanore  
dhe balancuesin e kapërcyer).

<sup>4)</sup> Rrjeti i vlerësuar, niveli i hyrjes.

## Seksioni i sintonizuesit FM

Diapazoni i sintonizimit  
87,5 MHz – 108,0 MHz

Antenë (ajrore)  
Antena FM me tel (ajrore)

Terminalet e antenës (ajrore)  
75 om, të pabalancuara

## Seksioni i sintonizuesit AM

Diapazoni i sintonizimit  
531 kHz – 1 602 kHz (hapa nga 9 kHz)

Antenë (ajrore)  
Antena në formë kornize (ajrore)

## Seksioni i videos

Hyrjet/daljet  
Video:  
1 Vp-p, 75 om

## Video HDMI

Hyrja/dalja (grup repetitor HDMI)

Formati	2D	3D		
		Frame packing	Side-by-Side (Half)	Over-Under (Top-and-Bottom)
4 096 × 2 160p @ 59,94/60 Hz	○ <sup>1)</sup>	-	-	-
4 096 × 2 160p @ 50 Hz	○ <sup>1)</sup>	-	-	-
3 840 × 2 160p @ 59,94/60 Hz	○ <sup>1)</sup>	-	-	-
3 840 × 2 160p @ 50 Hz	○ <sup>1)</sup>	-	-	-
4 096 × 2 160p @ 23,98/24 Hz	○ <sup>2)</sup>	-	-	-
3 840 × 2 160p @ 29,97/30 Hz	○ <sup>2)</sup>	-	-	-
3 840 × 2 160p @ 25 Hz	○ <sup>2)</sup>	-	-	-
3 840 × 2 160p @ 23,98/24 Hz	○ <sup>2)</sup>	-	-	-
1 920 × 1 080p @ 59,94/60 Hz	○	-	○	○
1 920 × 1 080p @ 50 Hz	○	-	○	○
1 920 × 1 080p @ 29,97/30 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 920 × 1 080p @ 25 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 920 × 1 080p @ 23,98/24 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 920 × 1 080i @ 59,94/60 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 920 × 1 080i @ 50 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 280 × 720p @ 59,94/60 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 280 × 720p @ 50 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 280 × 720p @ 29,97/30 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
1 280 × 720p @ 23,98/24 Hz	○ <sup>3)</sup>	○	○ <sup>3)</sup>	○ <sup>3)</sup>
720 × 480p @ 59,94/60 Hz	○ <sup>3)</sup>	-	-	-
720 × 576p @ 50 Hz	○ <sup>3)</sup>	-	-	-
640 × 480p @ 59,94/60 Hz	○ <sup>3)</sup>	-	-	-

<sup>1)</sup> Mbështet vetëm formatin YUV 4:2:0 / 8 bit.

<sup>2)</sup> Mbështet vetëm formatin 8 bit.

<sup>3)</sup> Këto formate mbështeten gjithashtu nga një lidhje MHL.

## Seksioni për MHL-në

Versioni i mbështetur i MHL-së

Përmban MHL 2

Rryma maksimale

900 mA

## Seksioni për iPhone/iPod

DC 5V 1,0 A MAX

USB funksionon me iPhone 5s, iPhone 5c, iPhone 5, iPhone 4s, iPhone 4, iPhone 3GS, iPhone 3G, iPod touch (2nd deri 5th generation), iPod classic dhe iPod nano (3rd deri 7th generation).

## Seksioni për USB-në

Formati i mbështetur\*

MP3 (MPEG 1 Audio Layer-3):

32 kbps – 320 kbps, VBR

WMA:

48 kbps – 192 kbps

AAC:

48 kbps – 320 kbps

WAV:

8 kHz – 48 kHz, 16 bit PCM

\* Nuk mund të garantohet pajtueshmëria me të gjithë softuerët kodues/shkrues, pajisjet regjistruese dhe mjetet regjistruese.

Shpejtësia e transferimit

Shpejtësia e plotë

Pajisja USB e mbështetur

Klasa e ruajtjes në masë

Rryma maksimale

500 mA

## Të përgjithshme

Furnizimi me energji

230 V AC, 50/60 Hz

Konsumi i energjisë

200 W

Konsumi i energjisë (gjatë modalitetit të gatishmërisë)

0,3 W (Kur [Control for HDMI]

(Kontrolli për HDMI) dhe [Pass Through] (Kalimi) janë të vendosura në [Off] (Joaktiv)).

0,5 W (Kur [Control for HDMI]

(Kontrolli për HDMI) vendoset në [On]

(Aktiv) dhe [Pass Through] (Kalimi)

është vendosur në [Off] (Joaktiv)).

Përmasat (gjerësia/lartësia/thellësia)

(afërsisht)

430 mm × 156 mm × 329,4 mm

përfshirë pjesët e dala dhe kontrollet

Masa (afërsisht)

7,6 kg

Dizajni dhe specifikimet i nënshtrohen ndryshimit pa dhënë njoftim.

Made for



iPod



iPhone

**HDMI**  **MHL**<sup>™</sup>

---

<http://www.sony.net/>

4-488-937-71(2) (AL)



\* 4 4 8 8 9 3 7 7 1 \* (2)